



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 541 prot.

Tiranë, më 17.04.2025

Lënda: Njoftim për përfitimin dhe kryerjen e shërbimeve me fonde buxhetore në kuadër të projektit për përmirësimin e aksesit së barabartë në shërbimet publike me standard të lartë nëpërmjet operacionit GOVTECH.

UNIVERSITETIT TË TIRANËS
UNIVERSITETIT TË DURRËSIT "ALEKSANDER MOISIU"
UNIVERSITETIT TË GJIROKASTRËS "EQEREM ÇABEJ"
UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
UNIVERSITETIT TË KORÇËS "FAN S. NOLI"
UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
UNIVERSITETIT TË VLORËS "ISMAIL QEMALI"

Në kuadër të zbatimit të projektit për "Përmirësimin e aksesit së barabartë në shërbimet publike me standard të lartë nëpërmjet operacionit GOVTECH" ratifikuar me ligjin 45/2023, datë 22.06.2023; në "Planin e implementimit dhe monitorimit të performancës për laboratorët Smart" miratuar me akt miratimi datë 01.12.2023, i ndryshuar me akt amendimi nr.1, datë 18.03.2025 me nr.prot. 1001/2 prot, datë 18.03.2025 (MAS) dhe nr. prot. 1261, datë 18.03.2025 (AKSHI), protokolluar pranë ASCAP me nr.480, datë 03.04.2025; në VKM. 188 datë 13.03.20219 "Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre (i ndryshuar, datë 27.03.2024)", në shkresën e përcjellë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me nr. prot 8208/3 datë 24.01.2025 protokolluar me tonën nr.233 prot, datë 29.01.2025, ku në fondet e miratuara të shpenzimeve korente për vitin 2025 është planifikuar realizimi i këtij projekti.

Për realizimin e planit të zbatimit dhe monitorimit të laboratorëve smart të Shqipërisë 2023-2025, i ndryshuar (i cili është ndarë në tre nënkomponent), është planifikuar shpërndarja e fondit si më poshtë:

Fondi limit (total): **29,009,965** (njëzetë e nëntë milion e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë.

Shënim: Ky fond është parashikuar të ketë një fond limit për secilin nënkomponent si vijon:

- **Nënkomponenti I:** Ngritja e kapaciteteve menaxhuese të drejtorëve të shkollave dhe punonjësve digjitalë për përdorimin e smartlabeve. Fondi limit i llogaritur sipas specifikimeve është **1.837.707** (një milionë e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatë) lekë.

- **Nënkomponenti 2:** Zbatimi i kurrikulës TIK dhe vlerësimi i rezultateve të nxënësve në lëndën TIK, për klasat I-III. Fondi limit i llogaritur sipas specifikimeve është **9.937.536** (nëntë milionë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.
- **Nënkomponenti 3:** Zbatimin i aftësive digjitale në lëndët e tjera dhe zhvillimi profesional i mësuesve të arsimit fillor. Fondi limit i llogaritur sipas specifikimeve është **16.834.722** (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzet e dy) lekë.
- **Menaxhimi i portalit të trajnimit:** Fondi limit i llogaritur sipas specifikimeve është 400.000 (katërqind mijë) lekë.

Bazuar në pikën 1 dhe 6 të vendimit 188, datë 13.03.2019 “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”, i ndryshuar, **kërkojmë nga ana juaj dorëzimin e ofertës ekonomike dhe formularin e deklarimit sipas pikës 4/D të termave të referencës, për realizimin e shërbimeve brenda 15(pesëmdhjetë) ditëve.**

Në mënyrë që çdo IAL publike të jetë e mirëorientuar mbi punën që do të kryhet, bashkëlidhur do të gjeni termat e referencës mbi projektin;

1. Termat e referencës

PËRMIRËSIMIN E AKSESIT SË BARABARTË NË SHËRBIMET PUBLIKE ME STANDARD TË LARTË NËPËRMJET OPERACIONIT GOVTECH

PLANIN E IMPLEMENTIMIT DHE MONITORIMIT TË PERFORMANCËS PËR LABORATORËT SMART I NDRYSHUAR

Nënkomponenti 1: Ngritja e kapaciteteve menaxhuese të drejtorëve të shkollave dhe punonjësve digjitalë për përdorimin e smartlabeve.

Nënkomponenti 2: Zbatimi i kurrikulës TIK dhe vlerësimi i rezultateve të nxënësve në lëndën TIK, për klasat I-III.

Nënkomponenti 3: Zbatimin i aftësive digjitale në lëndët e tjera dhe zhvillimi profesional i mësuesve të arsimit fillor.

Menaxhimi i portalit të trajnimit

1. PASQYRA E PËRGJITHSHME

Banka Botërore po financon programin për "Përmirësimin e Qasjes së Barabartë në Shërbimet Publike të Standardeve të Lartë përmes GovTech" me qëllim transformimin e mësimi, modernizimin e shërbimit ndaj klientit dhe sigurimin e aksesueshmërisë për të gjithë qytetarët, me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (referuar më poshtë AKSHI), si agjenci kryesore zbatuese. Një nga fushat e rezultateve të *Programit për Përmirësimin e Qasjes së Barabartë në Shërbimet Publike të Standardit të Lartë përmes GovTech* është “Përmirësimi

i aftësive digjitale dhe themelore”, i cili po zbatohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.

Ky komponent do të realizohet kryesisht përmes Laboratorëve Smart Edukative së bashku me infrastrukturën mbështetëse për mësimdhënien dhe të nxënit (me një theks të fortë në një qasje gjithëpërfshirëse), si dhe me ngritjen e kapaciteteve të 200 shkollave fillore nga Projekti GovTech i financuar nga Banka Botërore. Kjo iniciativë do të mbështesë gjithashtu edhe pilotimin e zgjidhjeve digjitale për mësimin në distancë në shkolla me klasa kolektive, ku pjesa më e madhe e nxënësve janë nga komuniteti rom. Laboratorët Smart do të përdoren për të mësuar aftësitë digjitale themelore në dy drejtime:

- për të mbështetur në mënyrë potenciale zbatimin e Kurrikulës së TIK-ut nga klasa 1-rë deri në klasë të 3-të si edhe në klasa të niveleve më të larta në vazhdim
- për të zhvilluar aftësitë numerike nga klasa e 1-rë deri në klasën e 3-të, si pjesë e kurrikulës kombëtare.

Në kuadër të këtij projekti janë financuar 216 Laboratorë Smart në 200 shkolla të arsimit bazë. Aktualisht MAS dhe ASCAP në bashkëpunim me grupin ndërinstitucional të hartimit të kurrikulave TIK ka hartuar dhe miratuar kurrikulat e reja të lëndës TIK-ut klasat I-III. Kurrikula përmban: programin lëndor, manualin e mësuesit dhe manualin (libër pune) të nxënësit. Gjithashtu në bashkëpunim me AADF është ofruar trajnimi për mësuesit e TIK-ut që japin mësim në klasë të parë, të dytë dhe të tretë në shkollat që janë pajisur me SmartLab si dhe janë siguruar licencat për nxënësit nga të gjitha shkollat pjesëmarrëse në platformën Code Monkey e siguruar dhe të financuar nga AADF deri në vitin 2026.

Përgjatë vitit 2024, filloi për herë të parë implementimi i projektit GovTech duke marrë në konsideratë ngritjen e kapaciteteve të drejtorëve të shkollave të pajisura me SmartLab dhe punonjësve të ZVAP-ve në lidhje me "Integrimin strategjik të SmartLabeve për një drejtim të suksesshëm dhe fuqizim të praktikave pedagogjike në shkollë", si dhe transformimin e lidershit në arsim përmes integritit teknologjik. Po ashtu, janë trajnuar mësuesit e arsimit fillor për aftësitë e nivelit bazë të kompetencës digjitale, bazuar në standardet profesionale të përdorimit të TIK-ut, si dhe është realizuar ngritja e kapaciteteve të trajnimit të mësuesve të TIK-ut në lidhje me përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në përdorimin e laboratorëve Smart. Gjithashtu, përgjatë vitit të parë të implementimit të projektit, përpos trajnimit të drejtorëve, mësuesve të arsimit fillor dhe mësuesve të TIK-ut, është ndërmarrë edhe procesi i

vlerësimin e rezultateve të nxënësve të klasës së parë dhe të dytë në lëndën e TIK-ut me instrumente testues për të matur njohuritë e tyre paraprake.

Termat e referencës përfshijnë tre nën-komponentë kryesorë që synojnë ngritjen e kapaciteteve menaxhuese dhe pedagogjike për integrimin e teknologjisë në arsimin fillor. Nën-komponenti i parë fokusohet në trajtimin e 253 drejtorëve të shkollave dhe specialistëve për menaxhimin e laboratorëve Smart dhe përfshirjen e aftësive numerike në klasat I-III. Nën-komponenti i dytë synon zbatimin e kurrikulës së TIK-ut dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve të klasave I-III përmes testeve dhe analizave të rezultateve, si dhe përfshirjen e inteligjencës artificiale në procesin mësimor përmes trajnimit të 200 mësuesve të TIK-ut. Nën-komponenti i tretë fokusohet në zbatimin e aftësive digjitale bazë për 400 mësues të rinj të arsimit fillor në lëndët e tjera dhe zhvillimin profesional të vazhduar për 800 mësuesit e arsimit fillor përmes trajnimeve të avancuara mbi përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie. Projekti gjithashtu përfshin hartimin e strategjive dhe moduleve të trajnimit për integrimin efektiv të laboratorëve Smart në arsimin fillor.

- ***Drejtorët e shkollave dhe specialistët e ZVAP-ve:*** Drejtorët e shkollave dhe specialistët e ZVAP-eve kanë një rol kyç në sigurimin e një zbatimi efektiv të SmartLabs, duke udhëhequr procesin e integrit të TIK-ut në shkollat e tyre. Ata do të trajnohen në menaxhimin e laboratorëve Smart dhe përfshirjen e aftësive numerike në procesin mësimor për klasat I-III. Përmes trajnimeve, drejtorët do të zhvillojnë aftësi për të mbështetur mësuesit në përdorimin e infrastrukturës digjitale dhe për të krijuar një mjedis inovativ të të nxënësve në shkollat e tyre.
- ***Mësuesit e arsimit fillor:*** Mësuesit e arsimit fillor do të trajnohen në kompetencat digjitale bazuar në standardet profesionale të TIK-ut, duke përfitur nga kurse të përshtatura sipas niveleve të tyre të ekspertizës. Ata do të angazhohen në trajnime për aftësitë digjitale të bazë dhe të avancuara, të cilat do t'i ndihmojnë të përdorin në mënyrë efektive SmartLabs për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënësve. Përmes zhvillimit profesional dhe mentorimit, mësuesit do të jenë të aftë të integrojnë teknologjinë në mësimdhënie dhe të zbatojnë metoda inovative për përmirësimin e rezultateve të nxënësve.
- ***Mësuesit e TIK-ut:*** Mësuesit e TIK-ut luajnë një rol kyç në zbatimin e suksesshëm të SmartLabs dhe integrimin e teknologjisë në procesin mësimor. Për këtë arsye, ata do të përfitojnë nga trajnimet specifike që synojnë zhvillimin e kompetencave të tyre në fushën e inteligjencës artificiale, përdorimin e mjeteve digjitale inovative dhe zbatimin efektiv të

metodologjive të reja të mësimdhënies. Këto trajnime do të përfshijnë aspekte metodologjike dhe praktike për të siguruar një përdorim optimal të infrastrukturës teknologjike në mbështetje të mësimdhënies dhe të nxënit.

2. NEVOJA PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE TË DREJTUESVE, MËSUESVE TË ARSIMIT FILLOR, MËSUESVE TË TIK DHE SPECIALISTË TË ZVAP-EVE PËR ZHVILLIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E AFTËSIVE DIGJITALE

Sigurimi i cilësisë në arsim dhe rritja e profesionalizimit të drejtuesve, mësuesve dhe specialistëve të ZVAP-eve udhëheqin gjithë angazhimin institucional të MAS-it në kuadër të prioritetëve të saj dhe të përmbushjes së Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026. Të gjitha hulumtimet tregojnë se cilësia e mësimdhënies është faktor përcaktues për arritjet e nxënësve. Nevoja për ngritjen e kapaciteteve të drejtorëve, mësuesve të arsimit fillor, mësuesve të TIK dhe specialistëve të ZVAP-eve për zhvillimin dhe fuqizimin e programeve digjitale është parësore në zhvillimin e sotëm arsimor.

- ✓ **Shkrim-leximi digjital:** Teksa teknologjia vazhdon të përparojë me shpejtësi, është thelbësore që mësuesit dhe drejtuesit e shkollave të jenë të aftë në vetë arsimimin digjital. Kjo përfshin aftësinë për të menaxhuar, kuptuar, integruar, komunikuar, vlerësuar, krijuar informacion në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshëm përmes teknologjisë digjitale si dhe të përdorin mjete, platforma dhe burime të ndryshme digjitale në mënyrë efektive për mësimdhënien dhe menaxhimin e praktikave të tyre të punës.
- ✓ **Përgatitja e nxënësve për të ardhmen:** Aftësitë digjitale janë gjithnjë e më thelbësore për suksesin në botën moderne. Duke rritur kapacitetet e mësuesve në arsimin digjital, nxënësit mund të përgatiten më mirë për vendet e punës me sisteme digjitale që do të hyjnë në të ardhmen.
- ✓ **Barazi dhe akses:** Programet digjitale shkollore mund të ndihmojnë në kapërcimin e vështirësive digjitale duke ofruar akses të barabartë në burimet dhe mundësitë arsimore për të gjithë nxënësit. Mësuesit dhe drejtuesit duhet të pajisen me aftësitë për të zhvilluar programe digjitale gjithëpërfshirëse që plotësojnë nevojat dhe stilet e ndryshme të të nxënit.
- ✓ **Metodat inovative të mësimdhënies:** Mjetet dhe platformat digjitale ofrojnë një gamë të gjerë mundësish për metoda inovative të mësimdhënies, si mësimi i personalizuar, përmbajtje e pasur me multimedia. Mësuesit kanë nevojë për trajnim për t'i integruar në mënyrë efektive këto mjete në praktikat e tyre të mësimdhënies për të rritur angazhimin e nxënësve dhe për të përmirësuar rezultatet e të nxënit.

- ✓ **Vendimmarrja e drejtuar nga të dhënat:** Edukimi digjital gjeneron sasi të mëdha të dhënash që mund të përdoren për të informuar strategjitë mësimore, për të ndjekur përparimin e nxënësve dhe për të marrë vendime të bazuara në të dhëna. Specialistët e ZVAP-eve dhe drejtuesit duhet të trajnohen në analizën dhe interpretimin e të dhënave për të shfrytëzuar potencialin e plotë të këtyre të dhënave për përmirësimin e rezultateve të nxënësve.
- ✓ **Inteligjenca Artificiale (IA):** Me rritjen e digjitalizimit vjen nevoja për masa të shtuara për përdorimin dhe integrimin e IA në procesin mësimor. Mësuesit e TIK duhet të trajnohen për praktikën më të mirë të përdorimit të IA jo vetëm në lëndën e TIK, por edhe më gjerë.
- ✓ **Zhvillimi profesional:** Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është thelbësor për mësuesit dhe drejtuesit që të qëndrojnë në krah të tendencave, mjeteve dhe praktikave më të fundit në arsimin digjital. Programet e trajnimit duhet të ofrohen për të mbështetur trajnimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e aftësive në këtë fushë me zhvillim të shpejtë.

Roli i institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në ngritjen e kapaciteteve të drejtuesve, mësuesve të arsimit fillor, mësuesve të TIK dhe specialistëve të ZVAP-eve për zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive digjitale është shumë i rëndësishëm. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të formimit fillestar të mësuesve, si diploma Bachelor dhe Master në arsim, të cilat u ofrojnë mësuesve aspirantë njohuritë, aftësitë dhe strategjitë e nevojshme pedagogjike për të qenë mësues efektivë përfshirë edhe përdorimin e teknologjisë në praktikën mësimore. Institucionet e arsimit të lartë gjithashtu kanë qendrat e edukimit në vazhdim, të cilat ofrojnë trajnime të specializuara dhe të akredituara që u mundësojnë mësuesve të thellojnë njohuritë e tyre në fusha specifike lëndore, praktikën e metodologjisë, arsimin e kombinuar, përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor, edukimin STEM; drejtuesit e shkollave i përgatisin në administrimin e saj më frymën e arsimit të kombinuar etj., duke rritur efektivitetin e tyre dhe duke u mundësuar mësuesve të qëndrojnë aktualë me tendencat dhe praktikën më të mirë në arsim.

Nga ana tjetër institucionet e arsimit të lartë angazhohen në kërkime dhe studime kërkimore që analizojnë praktikën e mësimdhënies, zhvillimin e kurrikulës dhe politikën arsimore për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme mësimdhënien dhe të nxënësve si dhe drejtimin e administrimit të shkollës.

Në përmbledhje, ngritja e kapaciteteve të drejtorëve, mësuesve të arsimit fillor, mësuesve të TIK dhe specialistëve të ZVAP-eve është kritike për zhvillimin dhe fuqizimin e programeve digjitale shkollore. Duke investuar në zhvillimin profesional të mësuesve dhe drejtuesve në

arsimin digjital, shkollat mund t'i përgatisin më mirë nxënësit për sukses në epokën digjitale dhe të promovojnë akses të barabartë në mundësi arsimore cilësore.

3. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

3.1 Qëllimi

Përmirësimi i aftësive digjitale dhe numerike të nxënësve në shkollat e pajisura me SmartLabs përmes trajnimit të drejtuesve të shkollave, mësuesve të arsimit fillor dhe mësuesve të TIK-ut. Ky proces do të fokusohet në zhvillimin e kompetencave digjitale si dhe në integrimin efektiv të SmartLabs në procesin mësimor, duke u mbështetur në standardet profesionale të TIK-ut dhe në metodologjitë e reja mësimore.

3.2 Qëllimi specifik

Qëllimi specifik është të përmirësojë aftësitë digjitale dhe numerike të nxënësve përmes fuqizimit të kapaciteteve të drejtuesve, mësuesve të arsimit fillor dhe mësuesve të TIK-ut në përdorimin e SmartLabs. Përmes trajnimeve, mentorimit dhe zbatimit të metodologjive të reja mësimore, do të synohet integrimi i teknologjisë në procesin mësimor dhe rritja e kompetencave të mësimdhënësve në aftësitë digjitale dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në mësimdhënie.

Objektivat e përgjithshme:

Objektivi 1: Ngritja e kapaciteteve të drejtuesve të shkollave dhe specialistëve të ZVAP-eve për menaxhimin dhe integrimin e aftësive numerike në procesin mësimor për klasat I-III. Përmes trajnimeve, drejtuesit do të aftësohen për të mbështetur mësuesit në përdorimin efektiv të SmartLabs dhe për të garantuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e aftësive numerike.

Objektivi 2: Trajnimi i mësuesve të TIK-ut në përdorimin e inteligjencës artificiale në mësimdhënie dhe përmirësimi i aftësive themelore digjitale dhe numerike të nxënësve, të cilat janë thelbësore në shoqërinë e sotme.

Objektivi 3: Zhvillimi profesional i mësuesve të arsimit fillor përmes trajnimeve mbi kompetencat digjitale bazuar në standardet profesionale të TIK-ut. Mësuesit do të aftësohen në përdorimin e infrastrukturës SmartLab dhe aplikimin e metodologjive të avancuara në mësimdhënie për të përmirësuar rezultatet e nxënësve.

Nënkomponentët e detyrës

- **Nënkomponenti 1:** Ngritja e kapaciteteve menaxhuese të drejtorëve të shkollave dhe punonjësve digjitalë (specialistë të ZVAP-eve) për përdorimin e smartlabeve.
- **Nënkomponenti 2:** Zbatimi i kurrikulës TIK dhe vlerësimi i rezultateve të nxënësve në lëndën TIK, për klasat I-III.
- **Nënkomponenti 3:** Zbatimin i aftësive digjitale në lëndët e tjera dhe zhvillimi profesional i mësuesve të arsimit fillor.

Treguesit specifikë për secilin nënkomponent janë si më poshtë:

Nënkomponenti 1: Ngritja e kapaciteteve menaxhuese të drejtorëve të shkollave dhe punonjësve digjitalë për përdorimin e smartlabeve. Treguesit specifikë janë:

- a) Hartimi i një moduli për trajnimin e vazhduar të 253 drejtorëve dhe specialistëve të ZVAP-eve në lidhje me menaxhimin dhe përfshirjen në procesin mësimor të aftësive numerike në laboratorët smart përgjatë klasave I-III. *Moduli do të zhvillohet në 2 ditë trajnimi.*
- b) Trajnimi i 253 drejtorëve të shkollave të pajisura me smartlab dhe specialistëve të ZVAP-eve në lidhje me menaxhimin dhe përfshirjen në procesin mësimor të aftësive numerike në laboratorët smart përgjatë klasave I-III. *Trajnimi dy ditë do të zhvillohet pranë ambienteve me infrastrukturë të përshtatshme digjitale, të përcaktuara nga IAL-ja.*

Nënkomponenti 2: Zbatimi i kurrikulës TIK dhe vlerësimi i rezultateve të nxënësve në lëndën TIK, për klasat I-III. Treguesit specifikë janë:

- a) Hartimi i instrumentit, i cili do të shërbejë si *post-test* për vlerësimin e arritjeve të nxënësve për klasën e parë.
- b) Realizimi i vlerësimit të rreth 5000 nxënësve të klasës së parë me *post-test* për njohuritë që kanë përfituar gjatë vitit shkollor 2024-2005.
- c) Hartimi i instrumentit, i cili do të shërbejë si *post-test* për vlerësimin e arritjeve të nxënësve për klasën e dytë.
- d) Realizimi i vlerësimit të rreth 5000 nxënësve të klasës së dytë me *post-test* për njohuritë që kanë përfituar gjatë vitit shkollor 2024-2005.
- e) Hartimi i dy raporteve përmbledhës për vlerësimin e nxënësve të klasës së parë dhe klasës së dytë për përvetësimin e njohurive dhe aftësive digjitale në lëndën e TIK-ut pranë grupit koordinues.

- f) Hartimi i manualit metodologjik për vlerësimin e arritjeve të nxënësve me pre-test dhe pos-test për rezultatet e nxënësve nga zbatimi i kurrikulës së klasës së tretë në lëndën e TIK-ut. *(maksimumi 50 faqe)*
- g) Hartimi i fondit të pyetjeve për vlerësimin e njohurive të nxënësve për programin mësimor të TIK-ut për klasën III. *(Fond pyetjesh 50 faqe)*
- h) Hartimi i instrumentit, i cili do të shërbejë si *pre-test* për vlerësimin e arritjeve të nxënësve për klasën e tretë.
- i) Realizimi i vlerësimit të rreth 5000 nxënësve të klasës së tretë me *pre-test* për nxënësit e klasës së tretë për vitin shkollor 2025-2026.
- j) Hartimi i strategjisë dhe qasjes më të përshtatshme për të përfshirë aftësitë numerike në laboratorët smart. *(maksimumi 40 faqe)*
- k) Organizimi i një seminarit me të gjithë aktorët me rol kyç për të diskutuar integrimin e mësimdhënies së aftësive numerike në Laboratorët Smart në të gjitha nivelet e klasave. *(rreth 50 persona pjesëmarrës)*
- l) Hartimi dhe implementimi i një moduli pilot për të testuar qasjen e propozuar të aftësive numerike me metodologjinë shoqëruese të vlerësimit formues dhe planin e zhvillimit profesional.
- m) Trajnimi me modulin pilot i 25 mësuesve të arsimit fillor për të testuar qasjen e propozuar të aftësive numerike me metodologjinë shoqëruese të vlerësimit formues.
- n) Rishikimi i variantit final të strategjisë së propozuar të qasjes më të përshtatshme për përfshirjen e aftësive numerike në smartlab mbas pilotimit të modulit.
- c) Hartimi i një moduli për trajnimin e vazhduar të 200 mësuesve TIK në lidhje përfshirjen e inteligjencës artificiale në procesin mësimor. *Moduli do të zhvillohet në 2 ditë trajnimi.*
- d) Trajnimi i 200 mësuesve TIK në lidhje përfshirjen e inteligjencës artificiale në procesin mësimor. *Trajnimi dy ditor do të zhvillohet pranë ambienteve me infrastrukturë të përshtatshme digjitale, të përcaktuara nga IAL-ja.*

Nënkompenti 3: Zbatimin i aftësive digjitale në lëndët e tjera dhe zhvillimi profesional i mësuesve të arsimit fillor. Treguesit specifikë janë:

- a) Trajnimi i 400 mësuesve *(shitesë)* të arsimit fillor për *aftësitë bazë* të mësuesve bazuar në standardet profesionale të TIK-ut *me modulet e trajnimit fillestar të hartuara gjatë zbatimit të programit GovTech në vitin 2024. Trajnimi gjashtë ditor (3 module x 2 ditë) do të zhvillohet pranë ambienteve me infrastrukturë të përshtatshme digjitale, të përcaktuara nga IAL-ja.*

- b) Mentorimi 1 ditor i 400 mësuesve (shtesë) të arsimit fillor për aftësitë bazë dhe të avancuara të mësuesve bazuar në standardet profesionale të TIK-ut.
- c) Trajnimi i 800 mësuesve (400 të trajnuar në vitin 2024 + 400 të trajnuar në vitin 2025) të arsimit fillor për aftësitë e avancuara të mësuesve bazuar në standardet profesionale të TIK-ut me modulet e trajnimit të vazhduar të hartuara gjatë zbatimit të programit GovTech në vitin 2024. Trajnimi katër ditor (2 module x 2 ditë) do të zhvillohet pranë ambienteve me infrastrukturë të përshtatshme digjitale, të përcaktuara nga IAL-ja.
- d) Trajnimi 1 ditor online i 800 mësuesve të arsimit fillor në lidhje me zbatimin në shkallë të gjerë të mësimdhënies së aftësive numerike në laboratorët smart përgjatë klasave I-III me modulën që u pilotua dhe u finalizua.

Tabela e treguesve dhe kritereve të performancës gjendet bashkëlidhur në shtojcën 1.

Tabela e shkollave me SmartLabe shtojca 2.

Formatet e databasave, shtojca 3

4. KOHËZGJATJA E ZBATIMIT

Zbatimi i nënkomponentëve do të realizohet gjatë periudhës maj – dhjetor 2025. Rezultatet e pritshme realizohen sipas afateve të përcaktuara në tabelën në shtojcën 1.

5. KRITERET E IAL-SË PËR ZBATIM

A. Kriteria për IAL-në në realizimin e detyrës:

- a) IAL duhet të ketë departamente të specializuara dhe të dedikuara në informatikë/TIK për formimin e aftësive digjitale të mësuesve të lëndës TIK me të paktën 50% të stafit akademik me titull të paktën doktor në këtë fushë.
- b) IAL duhet të ketë në dispozicion infrastrukturë shumë të mirë digjitale, të paktën 6 salla me të paktën 15 kompjuter/laptop funksionale dhe me lidhje të qëndrueshme interneti shpejtësi të paktën 50 Mgps për trajnimin e mësuesve.
- c) IAL duhet të ofrojë cikël të dytë studimi universitar për mësuesi në fushën informatikë/TIK.
- d) IAL duhet të ketë eksperiencë dhe përvojë në organizimin studimeve, analizave të thelluara dhe hartimin e raporteve në tre ciklet e studimit, në lidhje me matjen e aftësive digjitale të mësuesve dhe nxënësve apo përdorimit të tyre në sistemin arsimor.
- e) IAL duhet të ketë eksperiencë dhe përvojë në zhvillimin e platformave digjitale në funksion të edukimit si dhe përdorimin e Smartlab-eve në procesin mësimor.

- f) IAL duhet të ketë eksperiencë dhe përvojë në formimin e drejtuesve për drejtimin dhe menaxhimin e shkollës.
- g) IAL duhet të ketë eksperiencë dhe përvojë në organizimin e konsultave me ekspertë të fushës së TIK në lidhje me përfshirjen e aftësive digjitale në procesin mësimor në arsimin parauniversitar.
- h) IAL duhet të ketë eksperiencë dhe përvojë në organizimin e konsultave me ekspertë të fushës STEM në lidhje me përfshirjen e aftësive digjitale në lëndë të tjera veçanërisht në lëndët STEM.
- i) IAL duhet të ketë eksperiencë dhe përvojë në hartimin e moduleve, manualeve dhe materialeve të trajnimit të mësuesve, drejtuesve në arsimin parauniversitar.
- j) IAL duhet të ketë eksperiencë dhe përvojë në organizimin e trajnimeve të mësuesve dhe drejtuesve në arsimin parauniversitar.
- k) IAL duhet të ketë demonstruar më parë aftësi të mira në hartimin e planeve të trajnimeve dhe në zbatimin e përpiktë të tyre.
- l) IAL duhet të ketë eksperiencë dhe përvojë në organizimin e trajnimeve të mësuesve dhe drejtuesve në arsimin parauniversitar.
- m) IAL duhet të ketë demonstruar më parë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi me institucione të tjera për të realizuar aktivitete që lidhen me hartimin e ngritjen e kapaciteteve të punonjësve arsimorë.
- n) IAL duhet të ketë demonstruar aftësi të mira të raportimit me shkrim të realizimit të aktiviteteve të planifikuara në projekte të ngjashme.

B. Kriteria për ekspertët dhe trajnerët e IAL-së në zhvillimin e aktiviteteve:

Ekspertët dhe trajnerët që do të realizojnë aktivitetet e planifikuara duhet të kenë kualifikimet e mëposhtme:

- a) Formim akademik në fushën e informatikës dhe TIK.
- b) Formim akademik në fushën STEM (*Matematikë, Fizikë, Biologji, Kimi*)
- c) Formim akademik në fushën *Administrim Drejtimi*.
- d) Përvojë pune akademike në fushën përkatëse (të paktën 7 vite eksperiencë).
- e) Përvojë e mirë në ofrimin e trajnimeve me cilësi të lartë (të paktën 3 vite eksperiencë).
- f) Përvojë e mirë në vlerësimin e nxënësve të arsimit parauniversitar.
- g) Përvojë e mirë në studime dhe kërkim shkencor me cilësi të lartë.
- h) Botime të studimeve, artikujve, librave etj., në fushën përkatëse të edukimit.
- i) Udhëheqës të studimeve në tre ciklet e studimeve lidhur me përdorimin e teknologjisë në sistemin arsimor.

C. Kërkesa të tjera:

- a) Gatishmëri për të udhëtuar në qytete të ndryshme të Shqipërisë.
- b) Njohja e gjuhës angleze.
- c) Gatishmëri për punë gjatë fundjavave.
- d) Zotërim i aftësive për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë, të platformave interaktive dhe SmartLab-eve.
- e) Udhëheqës të diplomave në tre ciklet e studimit në fushën përkatëse.
- f) Aftësi të mira bashkëpunuese dhe komunikuese.

D. VLËRËSIMI I KRITEREVE

Kriteri i vlerësimit	Pesha	Dokumentimi
Aktiviteti i institucionit të arsimit të lartë në fushën e TIK.	20 pikë	Formati i aplikimit, fotokopje të marrëveshjeve për projekte të ngjashme, linkun e faqes së departamentit.
Infrastruktura e përshtatshme për trajnime.	20 pikë	Formati i aplikimit, foto nga mjediset dhe kontrata e shërbimit për internetin.
Formimi akademik i stafit të departamentit të informatikës.	20 pikë	Dëshmi për titullin akademik.
Eksperiencia e stafit akademik si trajner ose ekspert.	20 pikë	Formati i aplikimit. Përshkrim i shkurtër në të cilën evidentohet përvoja si trajner ose ekspert.
Botime të studimeve, artikujve, librave etj. në fushën përkatëse të edukimit.	20 pikë	Fotokopje të faqes së parë të botimit.

Shënim. Të gjitha dokumentet që dorëzon IAL të jenë të miratuara nga titullari i institucionit të arsimit të lartë si dhe IAL duhet të plotësojë formularin e deklaramit si më poshtë. Autoritetit kontraktor i lind e drejta të kërkojë dokumente shtesë kur e gjykon të arsyeshme.

FORMATI I DEKLARIMIT

Dokumentet e dorëzuara		Të dhënat
Të dhënat e IAL-së	Emri i institucionit të arsimit të lartë.	
	Emri i titullarit të IAL-së	
	Adresa e postës elektronike.	
	Numri i tel/cel.	
	Linku zyrtar.	
Llogaria Bankare	Banka	
	Numri i llogarisë	
	IBAN	
Të dhënat e fakultetit që ka departamentin e informatikës	Emri i fakultetit që ka departamentin e informatikës	
	Emri i titullarit të fakultetit që ka departamentin e informatikës	
	Adresa e postës elektronike	
	Numri i tel/cel	
	Linku zyrtar	
Të dhënat e departamentit të informatikës	Emri i departamentit të informatikës	
	Emri i titullarit të departamentit e informatikës	

	Adresa e postës elektronike	
	Numri i tel/cel	
	Linku zyrtar	
Drejtuesi i projektit	Emri	
	Adresa e postës elektronike	
	Numri i tel/cel	
	Linku zyrtar (nëse ka)	
Koordinatori i projektit	Emri	
	Adresa e postës elektronike	
	Numri i tel/cel	
	Linku zyrtar (nëse ka)	
2.1 Aktiviteti i departamentit të informatikës (veprimtaritë kyç të departamentit të informatikës, fushat që mbulon, bashkëpunimet, projektet, zhvillim platformash softwerike etj.)		
2.2 Infrastruktura, numri i pajisjeve digjitale, interneti, foto nga sallat etj.		
2.3 Formimi akademik i stafit, numri i stafit gjithsej të departamentit të informatikës, numri i profesorëve/ profesorëve të asociuar/doktorëve etj.		

2.4 Eksperienca, kualifikimet, botimet e stafit akademik përfshirë trajnerët dhe ekspertët që mund të angazhohen në aktivitetet e projektit.
2.5 Bashkëlidhur plani i aktiviteteve dhe buxheti

Titullari i IAL-së

.....

6. PËRSHKRIMI I PËRGJEGJËSIVE

Për realizimin e nënkomponentëve dhe treguesve, do të angazhohen:

A. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), me përgjegjësitë si më poshtë:

- Realizon workshop-in me ekspertët dhe trajnerët e institucionit të arsimit të lartë për informimin e përmbajtës së aktiviteteve të planifikuara në shtojcën 1.
- Njofton AKAP-në, DRAP-in dhe ZVAP-të për zbatimin e programit dhe për zhvillimin e aktiviteteve nga IAL.
- Disponon planin e punës të hartuar nga IAL në mënyrë të detajuar për secilin nga treguesit e nënkomponentëve me afate përkatëse.
- Mbledh kalendarin e trajnimeve të hartuar nga IAL në bashkëpunim me AKAP-në dhe DRAP-et përkatëse.
- Monitoron realizimin e aktiviteteve dhe trajnimeve të zhvilluara nga IAL për të siguruar efektivitetin e tyre.
- Mbledh të gjithë dokumentacionin e hartuar nga IAL për realizimin e aktiviteteve dhe trajnimeve.
- Siguron burimet financiare të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara.

B. Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL), me përgjegjësitë si më poshtë:

- a) Njeh Planin e implementimit dhe monitorimit të performancës për Laboratorët Smart të Shqipërisë 2023-2025 në kuadër të programit të Bankës Botërore “Përmirësimi i qasjes të barabartë në shërbimet publike me standard të lartë përmes programit GovTech”, i ndryshuar.
- b) Përcakton një drejtues projekti dhe /ose koordinator, në nivel IAL-je, për koordinimin me Njësinë e Koordinimit në MAS, ASCAP, AKAP, dhe ZVAP-ve.
- c) Siguron pjesëmarrjen e drejtuesit të projektit dhe/ose koordinatorit në të gjitha takimet me Bankën Botërore si dhe në takimet e grupit të implementimit të miratuar nga MAS dhe AKSHI.
- d) Bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP) si dhe me Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP -et) për databazën e drejtuesve, mësuesve dhe specialistëve të zyrave që do të trajnohen dhe përgatit ndarjen e tyre në grupe trajnimi.
- e) Miraton planin e punës në mënyrë të detajuar për secilin nga treguesit e nënkomponentëve me afate përkatëse dhe e dorëzon në ASCAP dhe në njësinë e koordinimit në MAS sipas afateve të kërkuara.
- f) Harton kalendarin e trajnimeve për vitin 2025, në bashkëpunim me AKAP, DRAP-et dhe e dorëzon brenda afatit të përcaktuar.
- g) Cakton ekspertët dhe trajnerët pedagogë, sipas kriterëve të përcaktuara, që do të angazhohen në realizimin e aktiviteteve dhe trajnimeve të drejtuesve, mësuesve dhe punonjësve digjitalë (specialistëve të ZVAP-eve).
- h) Planifikon dhe zbaton procedurat aktuale të realizimit të aktiviteteve të parashikuara në këto terma reference në koordinim me Njësinë e Koordinimit në MAS.
- i) Planifikon dhe zbaton procedurat aktuale të procesit të zhvillimit profesional të 800 mësuesve të arsimit fillor (400 mësues aktual + 400 mësues shtesë), 253 drejtuesve në shkollat e pajisura me smartlabs dhe specialistëve të ZVAP-eve, 200 mësuesve të TIK-ut.
- j) Realizon vlerësimet e 5000 nxënësve të klasave të para dhe të dyta me post-test, ndërmjet një instrumenti sipas niveleve të arritjes dhe harton raport përmbljedhës për rezultatet e nxënësve për secilën klasë.
- k) Realizon vlerësimet e 5000 nxënësve të klasave të treta me pre-test, ndërmjet një instrumenti sipas niveleve të arritjes.
- l) Harton materialet dhe organizon aktivitetet e parashikuara për secilin nga nënkomponentët e cituar në kreun 4) sipas planit të aktiviteteve me cilësi të lartë dhe përgjegjshmëri të plotë.

- m) Organizon një seminar me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve kyç, me qëllim diskutimin e integritetit të mësimdhënies së aftësive numerike në Laboratorët Smart në të gjitha nivelet e arsimit fillor, duke u mbështetur në mësimet e nxjerra gjatë vitit të parë të zbatimit.
- n) Komunikon me AKAP-në dhe DRAP-et përkatëse për njoftimin e mësuesve dhe për zhvillimin e ditëve të trajnimit sipas kalendarit të hartuar.
- o) Krijon kushte për të përgatitur materialet e trajnimit për secilin pjesëmarrës.
- p) Siguron mjediset e trajnimit, me projektor, laptop, kompjuterë për pjesëmarrësit në trajnim, veçanërisht mjedise me SmartLab-e.
- q) Bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP), si dhe me DRAP-et për sigurimin e mjediseve të mentorimit, të realizimeve të vlerësimeve të mësuesve apo të nxënësve.
- r) Hedh në portalin e trajnimeve të administruar nga RASH, listën e të gjithë mësuesve, dhe drejtuesve të trajnuar sipas moduleve përkatëse.
- s) Sigurohet që të gjithë pjesëmarrësit në trajnim të pajisen me certifikatën nga RASH për secilin prej moduleve të trajnimit.
- t) Realizojnë workshope dhe tryeza konsultimesh me ekspertë të fushës
- u) Publikon në rrjete sociale veprimtaritë trajnuese.

C. Drejtuesi i projektit dhe/ose koordinatori i LAL-së, me përgjegjësitë si më poshtë:

- a) Njeh Planin e zbatimit dhe monitorimit të Laboratorëve Smart të Shqipërisë 2023-2025 në kuadër të programit të Bankës Botërore “Përmirësimi i qasjes të barabartë në shërbimet publike me standard të lartë përmes programit GovTech”, i ndryshuar.
- b) Merr pjesë në të gjitha takimet me Bankën Botërore si dhe në takimet e grupit të implementimit të miratuar nga MAS dhe AKSHI.
- c) Raporton një herë në muaj në grupin e implementimit të ngritur me urdhër të MAS dhe AKSHI-t.
- d) Koordinon në mënyrë të vazhdueshme punën për realizimin e aktiviteteve të planifikuara me Njësinë e Koordinimit pranë MAS.
- e) Dërgon pranë grupit koordinues në ASCAP, të gjitha produktet dhe materialet e hartuara për vlerësim 3-5 ditë përpara fillimit të aktivitetit.
- f) Bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP) si dhe me Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP -et) për databazën e drejtuesve, mësuesve dhe specialistëve të ZVAP-eve që do të trajnohen dhe për ndarjen e tyre në grupe trajnimi.

- g) Harton planin e punës në mënyrë të detajuar për secilin nga treguesit e nënkomponentëve me afate përkatëse dhe e dorëzon të miratuar në ASCAP dhe njësinë e koordinimit në MAS sipas afateve të kërkuara.
- h) Harton kalendarin e trajnimeve, në bashkëpunim me AKAP, DRAP-et dhe e dorëzon brenda afatit të përcaktuar në ASCAP dhe njësinë e koordinimit në MAS.
- i) Koordinon punën me ekspertët dhe trajnerët pedagogë për realizimin e aktiviteteve, trajnimeve dhe mentorimeve të drejtuesve, mësuesve dhe punonjësve digjitalë.
- j) Komunikon me AKAP-në dhe DRAP-et përkatëse për njoftimin e mësuesve dhe për zhvillimin e ditëve të trajnimit/mentorimit sipas kalendarit të hartuar.
- k) Kujdeset që trajnerët të përgatisin dhe të zhvillojnë paketën e trajnimit: modulën e trajnimit në bashkëpunim me ASCAP-in, agjendën e trajnimit, fletët e punës, prezantimin në PPT, etj.
- l) Siguron që mjediset e trajnimit të jenë të pajisura me kompjuter dhe të mundësojnë përdorimin e SmartLab-eve nga pjesëmarrësit.
- m) Dorëzon pranë Komisionit të Akreditimit të Aktiviteteve të Zhvillimit Profesional (KAAZHP), modulet për akreditim, të cilat lidhen me zbatimin e trajnimeve të përcaktuar në termat e referencës, 3-5 ditë përpara fillimit të aktivitetit të përcaktuar.
- n) Bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP), si dhe me DRAP-et për sigurimin e mjediseve të mentorimit, të realizimeve të vlerësimeve të mësuesve apo të nxënësve.
- o) Krijon linku-n e trajnimit për secilin modul trajnimi në portalin e trajnimeve të RASH dhe kalendarin përkatës sipas akses-it login që ka në portalin e trajnimeve.
- p) Kryen regjistrimin e pjesëmarrësve në portalin e trajnimeve të RASH sipas kalendarit, për ata që nuk kanë mundur të regjistrohen para fillimit të trajnimit bazuar në listëprezencat përkatëse.
- q) Koordinon mbledhjen e të dhënave për çdo trajnim, me monitoruesit e DRAP-it dhe të ASCAP-it, sipas fishave përkatëse në formë elektronike.
- r) Hedh në portalin e trajnimeve të RASH, në bashkëpunim me trajnerin, vlerësimet e testeve të pjesëmarrësve në përfundim të trajnimit.
- s) Sigurohet që të gjithë pjesëmarrësit në trajnim të pajisen me certifikatën nga RASH për secilin prej moduleve të trajnimit.
- t) Dorëzon në Njësinë e Koordinimit, DRAP, AKAP dhe ASCAP databazën në Excel të pjesëmarrësve në trajnim në përfundim të fazës përkatëse.

- u) Dorëzon në Njësinë e Koordinimit dhe ASCAP të gjitha dokumentet e parashikuara në kapitullin 4 dhe në kriteret e performancës në shtojcën 1.
- v) Harton raportin përmbledhës për të gjitha aktivitetet sipas nënkomponentëve përkatës dhe përgatit të gjithë dosjen e dokumenteve të firmosura nga titullarët e IAL-së dhe e dorëzon në Njësinë e Koordinimit dhe në ASCAP.

D. Trajneri i IAL-së për zhvillimin e trajnimeve, me përgjegjësitë si më poshtë:

- a) Zbaton kalendarin e trajnimeve të përgatitur nga drejtuesi i projektit dhe/ose koordinatori i IAL-së dhe DRAP.
- b) Zhvillon modulet e trajnimit në përputhje me përmbajtjen e modulit.
- c) Përgatit agjendën e trajnimit, prezantimin në PPT të modulit, fletët e punës, listë- prezencat e pjesëmarrësve në trajnim.
- d) Regjistron pjesëmarrësit në listën e pjesëmarrësve (listëprezenca) sipas formatit të përcaktuar.
- e) Sigurohet që në listëprezencë të shkruhen vetëm emrat e pjesëmarrësve që janë në sallë.
- f) Shpërndan linku-n e trajnimit për modulën dhe kalendarin përkatës dhe kryen regjistrimin e pjesëmarrësve në trajnim në link-un përkatës, të siguruar nga koordinatori i IAL-së.
- g) Realizon seancat trajnuese në mjedise me SmartLab dhe duke krijuar mundësinë e përdorimit të teknologjisë nga pjesëmarrësit.
- h) Përdor platformat online për mbështetjen e trajnimit dhe të procesit të mësimdhënie-nxënies.
- i) Realizon seancat trajnuese në mënyrë cilësore dhe efektive.
- j) Mbështet dhe angazhon të gjithë pjesëmarrësit gjatë trajnimit.
- k) Zhvillon shembuj praktikë gjatë seancave të trajnimit.
- w) Kryen testin në përfundim të modulit dhe vlerëson pjesëmarrësit vetëm nëse kanë ndjekur të ditët e plota të trajnimit.
- x) Hedh në portalin e trajnimeve të RASH, në bashkëpunim me koordinatorin e IAL-së, vlerësimet e testeve të pjesëmarrësve në përfundim të trajnimit.
- l) Plotëson listën emërore të mësuesve në Exel, vetëm me të dhënat e pjesëmarrësve që janë trajnuar dhe që kanë kaluar me sukses testin e modulit.
- m) Përgatit raportin përmbledhës për trajnimet e realizuara nga ai sipas komponentëve përkatës, duke përfshirë problemet e identifikuara dhe sugjerimet për përmirësim (sipas formatit të përcaktuar), si më poshtë:
 - ✎ Informacion i përgjithshëm mbi trajnimet e kryera.

- ✎ Ecuria e seancave të trajnimit.
- ✎ Listë-prezencat, fotot dhe vlerësimet e pjesëmarrësve në trajnim.
- ✎ Rekomandimet dhe sugjerimet për përmirësim.

E. Ekspertët të tjerë:

- a) Hartojnë me cilësi të lartë një modul për trajnimin e vazhduar të drejtorëve lidhur me menaxhimin dhe përfshirjen në procesin mësimor të aftësive numerike në Laboratorët Smart përgjatë Klasave I-III.
- b) Hartojnë instrumente vlerësimi *post-test* për vlerësimin e nxënësve të klasës së parë dhe të dytë sipas niveleve të arritjes.
- c) Përgatisin raporte përmbledhëse mbi vlerësimin e nxënësve të klasës së parë, lidhur me përvetësimin e njohurive dhe aftësive digjitale në lëndën e TIK-ut. *Raportet duhet të përmbajnë të dhëna të detajuara mbi rezultatet e nxënësve, të ndara sipas niveleve të arritjes, gjinisë, si dhe të pasqyrojnë analizën në nivel kombëtar, sipas DRAP-eve, ZVAP-eve, si dhe ndarjen ndërmjet zonave urbane dhe rurale.*
- d) Hartojnë manualin metodologjik për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në klasën e tretë me pre-test, post-test për zbatimin e kurrikulës së TIK-ut.
- e) Hartojnë instrumente vlerësimi *pre-test* për vlerësimin e nxënësve të klasës së tretë sipas niveleve të arritjes.
- f) Hartojnë strategji për përcaktimin e qasjes më të përshtatshme për përfshirjen e aftësive numerike në Laboratorët Smart, si dhe përgatisin metodologjinë përkatëse, duke përfshirë edhe përdorimin e mundshëm të platformave shtesë dhe materialeve digjitale mbështetëse për zhvillimin e këtyre aftësive në procesin mësimor.
- g) Hartojnë me cilësi të lartë një modul për të testuar qasjen e propozuar të aftësive numerike, me metodologjinë shoqëruese të vlerësimit formues dhe planin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional për mësuesit pjesëmarrës.
- h) Hartojnë një raport për rezultatet e vlerësimit pilot dhe finalizojnë metodologjinë e propozuar për përfshirjen e aftësive numerike në laboratorët smart.
- i) Hartojnë me cilësi të lartë një modul për trajnimin e vazhduar të mësuesve të TIK-ut në lidhje me përfshirjen e inteligjencës artificiale në procesin mësimor.

F. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), me përgjegjësitë si më poshtë:

- a) Bashkëpunon me Njësinë e Koordinimit në MAS, ASCAP-in dhe me IAL-në për të realizuar aktivitetet e planifikuara në shtojcën 1.

- b) Harton databazën e shkollave që janë pajisur me SmartLab-e me të gjitha të dhënat përkatëse dhe ia vë në dispozicion IAL-së.
- c) Ngarkon DRAP-et për hartimin e kalendarit të trajnimeve, përcaktimin e mjediseve të trajnimit dhe njoftimin e mësuesve.
- d) Ndjek dhe monitoron zhvillimin e trajnimeve, mentorimeve nga IAL.
- e) I përgjigjet IAL-së për të dhëna apo për mbështetje logjistike.
- f) Publikon në rrjete sociale veprimtaritë trajnuese të mësuesve.

G. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP), me përgjegjësitë si më poshtë:

- a) Bashkëpunon me ZVAP-të përkatëse për të identifikuar drejtuesit, mësuesit dhe punonjësit digjital që do të përfshihen në trajnime.
- b) Harton në mënyrë të detajuar databazën e drejtuesve, mësuesve dhe punonjësve digjital (specialistëve) të ZVAP-eve dhe ia vë në dispozicion IAL-së.
- c) Bashkëpunon me IAL-në përkatëse dhe koordinatorët e tyre për hartimin e kalendarit, ndarjen e grupeve, përcaktimin e mjediseve dhe njoftimin e mësuesve.
- d) Dorëzon në Njësinë e Koordinimit në MAS, ASCAP dhe në AKAP kalendarin e trajnimeve të dakordësuar me IAL-në.
- e) Njofton mësuesit për pjesëmarrje në trajnime sipas kalendarit të hartuar në bashkëpunim me IAL-në përkatëse.
- f) Ndjek dhe monitoron sesionet trajnuese/mentoruese të zhvilluara nga IAL përkatëse.
- g) Komunikon me ZVAP-et për hedhjen e krediteve të mësuesve në portofolin digjital.
- h) Publikon në rrjete sociale veprimtaritë trajnuese.

RAPORTIMI DHE DORËZIMI I MAERIALEVE PËR VLERËSIM

Raportimi për kryerjen e detyrës do të realizohet në dy faza:

Faza e parë – 10 shtator 2025. Në përfundim të kësaj faze, IAL do të dorëzojë:

- a) Raportin përmbledhës për të gjitha aktivitetet e realizuara gjatë fazës së parë i cili përmban përshkrimin narrativ të aktiviteteve të realizuara gjatë kësaj periudhe.
- b) Dokumentacioni shoqërues për realizimin e secilit tregues dhe aktivitet të përcaktuar në tabelën bashkëlidhur termave të referencave (shtojca 1). Ky dokumentacion organizohet sipas numrit të aktivitetit për kriteret specifike dhe kërkesave të përcaktuara në kriteret e performancës duke respektuar afatet përkatëse.
- c) Databazën përmbledhëse në Excel të emrave të pjesëmarrësve të trajnuar dhe/ose të mentoruar nga IAL gjatë fazës së parë, sipas formatit bashkëlidhur (shtojca 3).

Faza e dytë - 20 dhjetor 2025. Në përfundim të kësaj faze, IAL do të dorëzojë:

- a) Raportin përmbledhës për të gjitha aktivitetet e realizuara gjatë fazës së parë i cili përmban përshkrimin narrativ të aktiviteteve të realizuara gjatë kësaj periudhe.
- b) Dokumentacioni shoqërues për realizimin e secilit tregues dhe aktivitet të përcaktuar në tabelën bashkëlidhur termave të referencave (shtojca 1). Ky dokumentacion organizohet sipas numrit të aktivitetit për kriteret specifike dhe kërkesave të përcaktuara në kriteret e performancës duke respektuar afatet përkatëse.
